# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 01/29**
**Datë: 13.02.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 02/29**
**Datë: 13.02.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt 2018, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike.

2. Obligohet Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 03/29**
**Datë: 13.02.2018**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt 2018, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 600,000 euro (gjashtëqind mijë euro) për realizimin e programit të Këshillit Organizativ për shënimin e 10 vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi, ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara, me kod (232-13100), kategoria e Shpenzimeve të Rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Programi 80500 – Përkrahja e Kulturës, në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve.

3. Obligohet e Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 04/29**
**Datë: 13.02.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt 2018, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Organizues për manifestimin gjithë-popullor për shënimin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili do të organizohet nën patronatin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, më 5, 6 dhe 7 mars, në këtë përbërje:

   1.1. Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, kryesues;
   1.2. Përfaqësues, Zyra e Kryeministrit, anëtar;
   1.3. Përfaqësues, Komuna e Skenderajt, anëtar;
   1.4. Përfaqësues, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, anëtar;
   1.5. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Jashtme, anëtar;
   1.6. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar.

2. Ftohen që ta dërgojnë nga një përfaqësues në Këshill Organizues:

   2.1 Zyra e Presidentit, anëtar;
   2.2 Kuvendi i Kosovës, anëtar;
   2.3 Komuna e Prishtinës, anëtar;
   2.4 Organizatat e dala nga Lufta e UÇK-së, anëtar;
   2.5 Asociacioni i Komunave të Kosovës, anëtar dhe
   2.6 Përfaqësues të OJQ-ve.

3. Për punën e Këshillit Organizues ndahen mjete financiare në vlerë prej 100,000.00 (njëqindmijë) euro, të cilat do të shfrytëzohen sipas nevojës për manifestim. Këto mjete ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100 dhe barten në Zyrën e Kryeministrit, nën programi Kabineti i Kryeministrit me kod 10700 në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime.

4. Obligohet Ministria e Financave, Zyra e Kryeministrit dhe Këshilli Organizues për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 05/29**
**Datë: 13.02.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Pasqyra Preliminare Financiare për ekzekutimin e buxhetit dhe bilancin e fondeve për vitin 2017.

2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për informim Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 06/29**
**Datë: 13.02.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 9 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt 2018, nxjerr këtë:

### V E N D I M

1. Aprovohen ndryshimet në Tabelat 3.1, 3.2, 4.1 dhe 4.2 të Ligjit nr 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, për përmbushjen e obligimieve të pakryera financiare nga viti paraprak për projekte kapitale shumëvjeçare në bazë të paragrafit 2 të nenit 9 të këtij Ligji.

2. Obligohen ministritë e ndikuara dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me Tabelat nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës për informim.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 07/29**
**Datë: 13.02.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), për financimin e "Projektit të Rrugëve Rajonale – Zhvillimi i procedurave të brendshme për aprovim".

2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Financave të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

***Qeveria - Vlada - Government***

---

**Nr. 08/29**
**Datë: 13.02.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW), Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Hidrodrini në Pejë, Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Radoniqi në Gjakovë, dhe Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Hidroregjioni në Prizren, për financimin e projektit "Mënjanimi i ujërave të zeza në Kosovën Jugperëndimore –FAZA V".

2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Financave të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

**Nr. 09/29**
**Datë: 13.02.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt 2018, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Z. Ekrem Kastrati emërohet Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë 3 (tre) vjet.

3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

4. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 10/29**
**Datë: 13.02.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt 2018, nxjerr këtë:

## V E N D I M
**Për krijimin e Komitetit Drejtues Ndërministror për zhvillimin e projektit "Autostrada Istog-Pejë-Deçan-Gjakovë-Prizren"**

1. Emërohet Komiteti Drejtues Ndërministror për zhvillimin e projektit "Autostrada Istog-Pejë-Deçan-Gjakovë-Prizren", në këtë përbërje:

    1.1. Ministri i Infrastrukturës – kryesues;
    1.2. Ministri i Financave – anëtar;
    1.3. Ministri i Zhvillimit Ekonomik – anëtar;
    1.4. Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – anëtar;
    1.5. Ministri i Zhvillimit Rajonal – anëtar.

2. Për marrjen e vendimeve nga Komiteti sipas pikës 1. të këtij vendimi, nevojitet vota afirmative e shumicës së anëtarëve të Komitetit, duke përfshirë votën afirmative të Ministrit të Infrastrukturës.

3. Ministria e Infrastrukturës do të jetë autoriteti kontraktues në procedurën e prokurimit për shërbimet e këshilltarit të transaksionit.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë